



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Punëve të Brendshme/ Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/Ministry of Internal Affairs**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**PROFILI VJETOR I MIGRIMIT**  
**2022**

**AUTORITETI QEVERTAR PËR MIGRIM**

**Prishtinë**  
**Dhjetor 2023**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara dhe i takojnë Autoritetit Qeveritar për Migrim - Qeveria e Republikës së Kosovës. Riprodhimi nuk është i lejuar pa autorizim. Në rast të përdorimit të të dhënave nga ky dokument, duhet cituar burimin.

*Kontakti:*

Autoriteti Qeveritar për Migrim  
Qeveria e Republikës së Kosovës  
Ministria e Punëve të Brendshme  
Tel: + 383 (0) 38 200 76 701 – 76 709  
[www.mpb.rks-gov.net](http://www.mpb.rks-gov.net)  
Adresa: Rruga "Luan Haradinaj" 14  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

## Qëllimi i Profilit Vjetorë të Migrimit për vitin 2022

Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë një pasqyrë të zhvillimeve në fushën e migrimit (imigrimit dhe emigrimit) për institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile, organizatat jo-qeveritare, komunitetin akademik/hulumtues, si dhe për palët e tjera të interesit. Dokumenti përmban analiza bazuar në statistika dhe evidencë dhe përfundon me rekomandime të cilat mund t'i shërbejnë mekanizmave vendimmarrës, me qëllim të përfshirjes së tyre në politika shtetërore dhe sektoriale që ndërlidhen me çështjet e migrimit dhe të zhvillimit socio-ekonomik të vendit.

Ky dokument pasqyron zhvillimet dhe ndryshimet në politika, legjislacion dhe ato institucionale që kanë ndodhur gjatë vitit 2022, ndërsa në pjesët e dokumentit ku nuk ka pasur zhvillime apo ndryshime, teksti ka mbetur i pandryshuar.

Analiza e trendeve të migrimit e prezantuar në këtë dokument mbulon periudhën 3-vjeçare nga viti 2020 deri në 2022, e paraqitur përmes figurave dhe tabelave, ku përfshihen potencialisht edhe periudhat paraprake në rast të ndonjë ndryshimi të dukshëm të trendeve migruese. Të dhënat administrative dhe statistikore të përdorur në këtë dokument, janë burim i sistemeve informative ekzistuese të institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe burimet evropiane dhe ndërkombëtare.

Struktura e dokumentit përfshin zhvillimet e politikave dhe legjislacionit, zhvillimet institucionale, si dhe analizën e të dhënave statistikore që ndërlidhen me fushën e migrimit.

Profili Vjetorë i Migrimit për vitin 2022 është hartuar nga ekspertë dhe zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës, të cilët njëherësh janë anëtarë të Autoritetit Qeveritar për Migrim.

# PËRMBAJTJA

---

<b>QËLLIMI I PROFILIT VJETORË TË MIGRIMIT PËR VITIN 2022</b> .....	<b>3</b>
PËRMBAJTJA.....	4
LISTA E FIGURAVE.....	6
LISTA E TABELAVE.....	7
SHKURTESAT.....	8
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>9</b>
<b>1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR SHTETIN</b> .....	<b>11</b>
1.1 POPULLSIA, MADHËSIA, VENDET FQINJE DHE GJATËSIA E KUFIJVE.....	11
<b>2. RRJEDHAT E PËRGJITHSHME TË MIGRIMIT DHE STOQET E MIGRIMIT</b> .....	<b>13</b>
2.1. RRJEDHAT E MIGRIMIT.....	13
2.1.1. <i>Imigrimi</i> .....	13
2.1.2. <i>Emigrimi</i> .....	14
2.1.3. <i>Migrimi neto</i> .....	14
2.2. STOQET E MIGRIMIT.....	15
2.2.1. <i>Stoqet e imigrimit</i> .....	15
2.2.2. <i>Stoqet e emigrimit</i> .....	15
2.2.3. <i>Stoku i migrimit neto</i> .....	15
<b>3. MIGRIMI I RREGULLT</b> .....	<b>17</b>
3.1. POLITIKAT DHE LEGJSLACIONI.....	17
3.2. IMIGRIMI I RREGULLT.....	18
<i>Lejet e qëndrimit të përkohshëm</i> .....	18
<i>Lejet e qëndrimit të përhershëm</i> .....	20
<i>Leje pune afatshkurta</i> .....	21
3.3. EMIGRIMI I RREGULLT.....	21
<i>Shtetasit e Republikës së Kosovës me leje të vlefshme qëndrimi në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen</i> .....	21
3.4. LIRIMI I SHTETËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	23
<b>4. MIGRIMI I PARREGULLT</b> .....	<b>25</b>
4.1. POLITIKAT DHE LEGJSLACIONI.....	25
4.2. IMIGRIMI I PARREGULLT.....	25
<i>Refuzimi i hyrjeve</i> .....	25
<i>Kalimi i paautorizuar i kufirit</i> .....	26

<i>Shtetasit e huaj me qëndrim të paligjshëm të urdhëruar të largohen vullnetarisht, përfshirë edhe statistikat për kthim të asistuar vullnetar sipas marrëveshjes me IOM-in</i> .....	27
<i>Luftimi i kontrabandimit me migrantë</i> .....	30
<i>Trafikimi me qenie njerëzore</i> .....	32
<b>4.3. EMIGRIMI I PARREGULLT</b> .....	<b>33</b>
<i>Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose janë zënë në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen</i> .....	33
<i>Shtetasit kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen</i> .....	34
<i>Shtetasit kosovarë me qëndrim të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen me urdhër për largim</i> .....	35
<i>Shtetasit kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhrit për largim</i> .....	35
<b>5. RIPRANIMI DHE RIINTEGRIMI</b> .....	<b>37</b>
5.1. POLITIKAT DHE KORNIZA LIGJORE / RIPRANIMI .....	37
<i>Statistikat</i> .....	37
5.2. POLITIKAT DHE KORNIZA LIGJORE / RIINTEGRIMI .....	39
<i>Statistikat</i> .....	39
<b>6. INTEGRIMI I TË HUAJVE</b> .....	<b>41</b>
6.1. POLITIKAT DHE KORNIZA LIGJORE .....	41
<i>Fitimi i shtetësisë së Republikës së Kosovës</i> .....	41
<i>Skema e integritit të të huajve</i> .....	42
<b>7. MIGRIMI DHE ZHVILLIMI</b> .....	<b>44</b>
<i>Statistikat</i> .....	44
7.1. DËRGESAT E EMIGRANTËVE (REMITANCAT) .....	44
7.2. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE .....	45
7.3. SHËRBIMET E UDHËTIMIT TË VIZITORËVE NË KOSOVË / TURIZMI I DIASPORËS NË KOSOVË .....	45
<b>8. MBROJTJA NDËRKOMBËTARE</b> .....	<b>48</b>
8.1. POLITIKAT DHE LEGJISLACIONI.....	48
8.2. AZILKËRKUESIT NË KOSOVË / STATISTIKAT .....	48
8.3. AZILKËRKUESIT KOSOVARË NË SHTETET ANËTARE TË BE-SË DHE TË ZONËS SCHENGEN.....	50
<i>Aplikimi i mëvonshëm</i> .....	51
<i>Kërkesat për azil në Mbretërinë e Bashkuar</i> .....	51
<b>9. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET</b> .....	<b>53</b>
9.1. PËRFUNDIMET .....	53
9.2. REKOMANDIMET.....	54

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Imigrimi në Kosovë sipas viteve,.....	13
Figura 2: Emigrimi nga Kosova i vlerësuar nga ASK-ja sipas viteve.....	14
Figura 3: Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm sipas lejeqëndrimeve për herë të parë dhe në vazhdim .....	18
Figura 4: Numri dhe trendi i lejeve të qëndrimit të përkohshëm me qëllim të punësimit sipas lejeqëndrimeve për herë të parë dhe në vazhdim.....	19
Figura 5: Numri i vendimeve për lejeqëndrim të përkohshëm me Shqipërinë sipas Marrëveshjes,2022 .....	20
Figura 6: Numri i lejeve të punës afatshkurtër sipas vitit.....	21
Figura 7: Emigrantët kosovarë në shtetet e BE-së dhe zonës Schengen, sipas arsyes së qëndrimit23	
Figura 8: Numri i personave që janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës .....	24
Figura 9: Numri i imigrantëve që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar .....	27
Figura 10: Numri i të akomoduarve në Qendrën e Pritjes së Përkohshme .....	28
Figura 11: Numri i vendimeve për largim vullnetar, vullnetar IOM, me forcë dhe me vendim gjykate .....	30
Figura 12: Rastet e iniciuara të kontrabandës me migrantë .....	30
Figura 13: Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi, janë zënë me qëndrim të parregullt janë urdhëruar të largohen dhe janë larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen .....	36
Figura 14: Ripranimi vullnetar dhe me forcë.....	38
Figura 15: Ndihma menjëherë pas arritjes dhe ndihmat emergjente brenda 12 muajve pas riatdhesimit .....	39
Figura 16: Ndihma për riintegrim të qëndrueshëm.....	40
Figura 17: Numri i personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës .....	41

Figura 18: Numri i vendimeve pozitive për fitim të shtetësisë së R. Kosovës me dekret presidencial .....	42
Figura 19: Numri i personave të cilat kanë përfituar nga skemat e integritit.....	43
Figura 20: Të hyrat nga remitancat .....	44
Figura 21: Investimet e huaja direkte në Kosovë të shprehura në miliona euro dhe si përqindje e BPV-së .....	45
Figura 22: Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve .....	46
Figura 23: Të hyrat e përgjithshme nga Diaspora.....	47
Figura 24: Numri i azilkërkueseve sipas viteve .....	49
Figura 25: Azilkërkuesit kosovarë në shtetet e BE-së dhe të zonës Schengen .....	50
Figura 26: Vendimet fillestare për azilkërkuesit kosovarë në Mbretërinë e Bashkuar (%).....	52

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Rrjedhat e migrimit: imigrimi, emigrimi dhe migrimi neto për vitet.....	14
Tabela 2: Stoqet e imigrimit dhe rrjedhat e imigrimit të shprehura në numra absolut dhe relativ15	
Tabela 3: Stoqet e emigrimit dhe rrjedha e emigrimit të shprehura në numra absolut dhe relativ15	
Tabela 4: Stoqet e migrimit neto të shprehura në numra absolut dhe relativ .....	15
Tabela 5: Refuzim i hyrjeve në Pikë Kalimet Kufitare.....	26
Tabela 6: Numri i të dyshuarit për kontrabandë me migrantë sipas shtetësisë .....	31
Tabela 7: Numri i viktimave të evidentuara të kontrabandimit me migrantë sipas shtetësisë 202232	
Tabela 8: Numri i viktimave të trafikimit sipas shtetësisë.....	32
Tabela 9: Numri i inspektimeve, Planet Operative, Operacionet Policore të realizuar gjatë viteve33	
Tabela 10: Numri i vendimeve sipas statusit për vitin 2022.....	49

## SHKURTESAT

Shkurtesa	Përshkrimi
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
AQM	Autoriteti Qeveritar për Migrim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Adminitrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DMH	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj
DRPRIH	Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimi i të Huajve
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
DHKO	Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar
DHTQNJ	Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
EUROSTAT	Zyra e Statistikave të Bashkimit Evropian
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IOM/ ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
KKR	Komisioni Kombëtar për Refugjatë
MASHTI	Ministria Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
ME	Ministria e Ekonomisë
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PK	Policia e Kosovës
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
PRE	Programi i Reformave në Ekonomi
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
QPPM	Qendra e Pritjes Përkohshme për Migrantë
RKS	Republika e Kosovës
SKZH	Strategjia Kombëtare Zhvillimore
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës raportuese 2020 -2022, Republika e Kosovës ka arritur të konsolidoj dukshëm sistemin për menaxhimin e migracionit, duke fuqizuar mekanizmat përgjegjës institucional. Në këtë kontekst padyshim se ndër rezultatet kryesore ka qenë fuqizimi i Autoritetit Qeveritar për Migrim, si një mekanizëm këshillëdhënës i cili ka mbështetur institucionet përgjegjëse për menaxhimin e migrimit përmes zhvillimit të politikave strategjike dhe dokumenteve analitike duke u bazuar në të dhëna.

Në muajin Shtator 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoj Vendimin Nr.14/96 për plotësimndryshimin e Vendimit 08/158 për themelimin e AQM-së, duke e konsoliduar kështu bazën ligjore për funksionimin e këtij mekanizmi. Sipas Vendimit të Qeverisë për përcaktimin e përgjegjësive dhe detyrave dhe Udhëzuesit të Punës të AQM-së, përveç nivelit strategjik dhe sekretariatit, në kuadër të AQM-së funksionojnë edhe gjashtë (6) grupe tematike të cilat adresojnë çështjet si në vijim: migrimin e rregullt dhe mobilitetin, migrimin e parregullt, migrimin e brendshëm, komunikimin, riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve, si dhe të dhënat në fushën e migrimit.

Në aspektin e zhvillimeve strategjike është hartuar dhe miratuar Strategjia për Migrim 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2023 (e miratuar me Vendimin e Qeverisë 10/39, më datë 13.10.2021). Kjo Strategji përmban katër objektiva strategjike si dhe masa konkrete lidhur me menaxhimin e migrimit, parandalimin e migrimit të parregullt, avancimin e sistemit të migrimit të brendshëm, si dhe avancimin e qeverisjes së migrimit.

Zgjerimi i kapaciteteve akomoduese sipas Planit të Reagimit Emergjent, themelimi i Qendrës për Pritjen e Përkohshme, avancimi i praktikave për regjistrimin, profilizimin dhe referimin e migrantëve, janë disa nga të arriturat tjera kryesore përgjatë kësaj periudhe.

Padyshim se përveç rezultateve të arritura, Institucionet e Republikës së Kosovës janë ballafaquar edhe me sfida në menaxhimin e migrimit, të ndikuar nga faktorë të ndryshëm, gjatë periudhës 2020-2022. Ndër faktorët kryesor të cilët kanë ndikuar ka qenë pandemia Covid-19. Masat e ndërmarra nga shtetet e ndryshme, përfshirë edhe mbylljen e kufijve, kanë ndikuar që të kemi një numër të konsiderueshëm të migrantëve të 'ngujuar' brenda territorit të Republikës së Kosovës. Institucionet përgjegjëse ndërmorrën masat parandaluese për të mbrojtur migrantët nga pandemia, duke përfshirë kufizimin e lëvizjes dhe karantinën për migrantët dhe aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare në

ardhje.<sup>1</sup> Kjo ka ndikuar në stërngarkimin e sistemit vendor të pritjes dhe akomodimit të migrantëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, ku përveç shfrytëzimit të hapësirave në Qendrën e Azilit në Magure, është vu në funksion edhe objekti i Qendrës së Pritjes së Përkohshme në Vranidoll.

Po ashtu, situata me pandeminë Covid-19 ka ndikuar edhe në kthimin e organizuar të shtetasve të Kosovës që kanë mbetur të bllokuar në shtetet e ndryshme për arsye të humbjes së vendit të punës, duke përfshirë këtu edhe kategorinë e studentëve dhe të tjerët që kanë udhëtuar për qëllime biznesore apo vizita familjare. Procesi i ripranimit të shtetasve Kosovarë me qëndrim të paligjshëm në vendet e BE-së dhe zonës Schengen ishte suspenduar për disa muaj gjatë mbylljes së kufijve dhe kjo ka rezultuar me një numër dukshëm më të ulët të ripranuarve në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019.

---

<sup>1</sup>Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2020, faqe 46

# 1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR SHTETIN

## 1.1 Popullsia, madhësia, vendet fqinje dhe gjatësia e kufijve

Republika e Kosovës është shteti më i ri në Gadishullin Ballkanik me një pozicion gjeografik qendror e rrethuar me Republikën e Shqipërisë, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Republikën e Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë.

Republika e Kosovës është shteti i së drejtës me demokraci parlamentare i bazuar mbi parimin e ndarjes së pushteteve në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv dhe është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore. Shtylla e tretë është pushteti gjyqësor, i cili është i pavarur, unik dhe ushtrohet nga gjykatat. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit.



**Rajoni:** Evropa Juglindore.

**Gjerësia e territorit të Kosovës:** 41° 51' 21 dhe 43° 16'.

**Gjatësia e territorit të Kosovës:** 19° 59' dhe 21° 47'.

**Emri zyrtar:** Republika e Kosovës.

**Kryeqyteti:** Prishtina.

**Gjatësia e kufijve:** Me Republikën e Shqipërisë në jugperëndim 113.551 km, me Republikën e Maqedonisë së Veriut në jug 170.772 km, me Republikën e Malit të Zi në veriperëndim 79.165 km, me Republikën e Serbisë në verilindje 380.068 km. Kufiri i Republikës së Kosovës me vendet fqinje

kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror, kurse gjatësia e përgjithshme e kufirit është 743.556 km<sup>2</sup>.

**Sipërfaqja**<sup>3</sup>: 10,908 km.<sup>2</sup>

**Vendet fqinje**: Republika e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, Republika e Serbisë.

**Popullsia**: 1,762,220 (e vlerësuar më 31 dhjetor 2022).

**Dendësia e popullsisë**: 162 banorë për 1 km.<sup>2</sup>

**Forma e qeverisjes**: Republikë Parlamentare.

**Valuta**: Euro (EUR).

**Dita e pavarësisë**: 17 shkurt 2008.

**President**: Znj. Vjosa Osmani.

---

<sup>2</sup> Strategjia Shtetërore e Republikë së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2020-2025  
<https://mpb.rksgov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/364/Strategjia%202020-2025.pdf>

<sup>3</sup> Po aty

## 2. Rrjedhat e përgjithshme të migrimit dhe stoqet e migrimit


Popullsia rezidente në Kosovë në fund të vitit 2022 (31 dhjetor 2022) është vlerësuar të jetë 1,762,220 banorë. Agjencia e Statistikës së Kosovës çdo vit bën vlerësimin e numrit të popullsisë, duke përfshirë të dhënat për migrimin, me përdorimin e metodologjisë së standardizuar me qëllim të gjithëpërfshirjes së të gjitha grupeve të migrimit.

### 2.1. Rrjedhat e migrimit

#### 2.1.1. Imigrimi

Sipas vlerësimit të ASK-së gjatë vitit 2022, pjesëmarrja e imigrantëve në popullsinë e përgjithshme rezidente ishte 0.6% apo 10,664 persona<sup>4</sup> Në këtë shifër janë përfshirë të gjitha kategoritë e imigrantëve (shtetas kosovarë kthyer/ripranuar dhe të huaj) pa marrë parasysh arsyen e imigrimit.

Figura 1: Imigrimi në Kosovë sipas viteve,



Burimi: ASK


Për periudhën 2020-2022, të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i personave që kanë imigruar gjatë këtyre viteve janë shtetas kosovarë (migrantë të kthyer/ripranuar) dhe të huaj, me një mesatare vjetore prej 8,776 personave të popullsisë së përgjithshme rezidente brenda viti.

<sup>4</sup> Burim:ASK <https://ask.rks-gov.net/media/6105/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

### 2.1.2. Emigrimi

Numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2022, i vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ishte gjithsej 41,553 persona<sup>5</sup> apo 2.36 % e popullsisë rezidente. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë emigrantët pa marrë parasysh arsyen e migrimit dhe statusin e tyre (rregullt dhe parregullt).

Figura 2: Emigrimi nga Kosova i vlerësuar nga ASK-ja sipas viteve



Burimi: ASK

Të dhënat për periudhën 2020-2022 tregojnë se Kosova vazhdon të ketë shkallë të lartë të emigrimit me një mesatare vjetore prej 31,001 personave apo 1.78% të popullatës kosovare.

### 2.1.3. Migrimi neto

Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2022 ishte - 30,889 banorë apo 1.75% e popullsisë rezidente. Për periudhën 2018-2022 vlerësohet se nga Kosova janë larguar 156,080 banorë apo rreth 8.85% e popullsisë së vendit.

Tabela 1: Rrjedhat e migrimit: imigrimi, emigrimi dhe migrimi neto për vitet

Vitet	Imigrimi	Emigrimi	Net migrimi (nr.absolut)	Net migrimi (përqindje)
2020	11,543	8,724	2,819	0.16
2021	4,122	42,728	-38,606	-2.18
2022	10,664	41,553	-30,889	-1.75

Burimi: ASK

<sup>5</sup> Burim:ASK <https://ask.rks-gov.net/media/6105/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

## 2.2. Stoqet e migrimit

### 2.2.1. Stoqet e imigrimit

Për periudhën 2020-2022 vlerësohet të kemi rritje të stoqeve të imigrimit për 14,786 apo rreth 0.84% të popullsisë.

Tabela 2: Stoqet e imigrimit dhe rrjedhat e imigrimit të shprehura në numra absolut dhe relativ

Viti	Gjithsej popullsia	Stoku i imigrimit (numra absolut)	Stoku (përqindje)
2020	1,798,186	78,281	4.35
2021	1,773,971	82,403	4.65
2022	1,762,277	93,067	5.28

Burimi: ASK

### 2.2.2. Stoqet e emigrimit

Tabela 3: Stoqet e emigrimit dhe rrjedha e emigrimit të shprehura në numra absolut dhe relativ

Viti	Gjithsej popullsia	Stoku i emigrimit (numra absolut)	Stoku (përqindje)
2020	1,798,188	253,805	14.11
2021	1,773,791	296,533	16.70
2022	1,762,277	338,086	19.2

Burimi: ASK

### 2.2.3. Stoku i migrimit neto

Gjatë periudhës 2020-2022, në Kosovë imigruan 26,329 banorë, ndërsa emigruan mbi 93,005 banorë dhe popullata e Kosovës gjatë kësaj periudhe është zvogëluar për më shumë se 8,776 banorë.

Tabela 4: Stoqet e migrimit neto të shprehura në numra absolut dhe relativ

Vitet	Gjithsej popullsia	Rrjedhat e imigrimit (numra absolut)	Rrjedhat e emigrimit (numra absolut)	Rrjedhat neto të emigrimit, sipas viteve	Stoku neto i migrimit (numra absolut)	Stoku neto (në raport me shpërndarjen e popullsisë)
2020	1,798,188	11,543	8,724	2,819	880,224	48.95
2021	1,773,971	4,122	42,728	-38,606	918,830	51.8
2022	1,762,220	10,664	41,553	-30,889	949,719	53.89

Burim: ASK

Nëse merret si bazë popullsia që jetonte jashtë vendit më 1 prill 2011 (703,978 banorë vlerësohet se jetonin jashtë vendit), në fund të vitit 2022 vlerësohet se mbi 949,719 banorë apo 53.89 % e popullsisë së Kosovës jetonte jashtë vendit.



### 3. Migrimi i rregullt

Menaxhimi i migrimi të rregullt, është përgjegjësi e ndarë në mes të dy institucioneve kryesore në Kosovë, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, e para duke rregulluar këtë çështje përmes kornizës ligjore dhe institucionale dhe e dyta duke ofruar shërbime të punësimit dhe trajnime profesionale<sup>6</sup>.

#### 3.1. Politikat dhe legjislacioni

Migrimi i rregullt (imigrimi) në Republikën e Kosovës, duke përfshirë imigrimin për qëllime punësimi është i rregulluar me Ligjin për të Huajt<sup>7</sup> dhe aktet tjera nënligjore.

**Ligji Nr.04/L-219 për të Huajt** - <sup>8</sup> Ky ligj rregullon kushtet e hyrjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Në muajin Maj 2018, Ligji bazik për të Huajt Nr.04/L-219 është plotësuar dhe ndryshuar më **Ligjin Nr. 06/L-036** <sup>9</sup>. Me miratimin e Ligjit Nr.06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt është bërë inkorporimi i Ligjit për Dhënien e Lejes për Punë dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës. Po ashtu, janë inkorporuar disa dispozita ligjore me qëllim të lehtësimit të procedurës për lëshimin e lejes së punës për të huajt, procedurat për urdhër largimin vullnetar dhe urdhër largimin me forcë, si dhe shqiptimin e gjobave për të huaj. Në fund të vitit 2022, ka filluar puna në hartimin e Ligjit të ri për të Huajt, i cili në momentin e hyrjes në fuqi do të shfuqizojë Ligjin Nr.04/L-219 dhe Ligjin Nr.06/L-036.

Gjatë vitit 2022 janë miratuar aktet nënligjore si në vijim:

- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 05/2022 për Komisionin e Ankesave për të Huajt.
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për lehtësimin e procedurave dhe kushteve për marrjen e lejeqëndrimit të përkohshëm për shtetasit e Shqipërisë, me dt.10.02.2022, ka hyrë në fuqi dhe nga dt.11.02.2022, ka filluar zbatimin e kësaj Marrëveshje.

<sup>6</sup> Rregullore (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (rks-gov.net).

<sup>7</sup> Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16333>

<sup>8</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>

<sup>9</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>

Korniza kryesore ligjore që rregullon integrimin e të huajve në Republikën e Kosovës është Rregullorja (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve e cila gjithashtu rregullon bazën e sistemit të integrimin të huajve në Republikën e Kosovës. Rregullorja përcakton procedurat, kriteret dhe institucionet përgjegjëse për integrimin e të huajve në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore në Republikën e Kosovës.


## 3.2. Imigrimi i rregullt

### *Lejet e qëndrimit të përkohshëm*

Gjatë vitit 2022 janë lëshuar gjithsej 6,245 vendime pozitive për lejqëndrime të përkohshme prej tyre: Lejqëndrime për herë të parë 2,250 (33%) dhe Lejqëndrime në vazhdim 3,994 (67%).

Nga krahasimi i viteve 2021 dhe 2022, shihet që në vitin 2022 (6,245) kemi rritje prej 46% të numrit të lejqëndrimeve pozitive në të gjitha kategoritë në krahasim me vitin 2021 (4,281).

Figura 3: Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm sipas lejqëndrimeve për herë të parë dhe në vazhdim




Burimi: MPB/DSHAM

Gjatë vitit 2022, për herë të parë dhe në vazhdim lejqëndrime për qëllime punësimi janë lëshuar 2,976 (48%), për kategorinë e bashkimit familjar 2,740 (44%), për studim/shkollim 400 (6.4%) dhe për arsye të tjera 128 (2%) lejqëndrimi të përkohshme.

Sipas gjinisë, nga numri i përgjithshëm i 6,244 vendimeve pozitive për lejqëndrim të përkohshëm, 2,553 (41%) janë meshkuj kurse 3,691 (59%) janë femra.

Shtetet më të përfaqësuara me numrin e lejeve të qëndrimit të përkohshëm gjatë vitit 2022 janë: Shqipëri 1,789 (29%), Serbi 1,297 (21%), Turqi 1,197 (19%), Maqedonia e Veriut 643 (10%), SHBA 259 (4%) dhe shtete të tjera 1,059 (17%).

Figura 4: Numri dhe trendi i lejeve të qëndrimit të përkohshëm me qëllim të punësimit sipas lejeqëndrimeve për herë të parë dhe në vazhdim




Burimi: MPB/DSHAM

Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm për arsye punësimi, gjatë vitit 2022 ka pasur një trend ngritjeje prej 40% krahasuar me vitin 2021. Në përgjithësi, faktorët që mund të kenë ndikuar në ngritjen e punësimit të të huajve në Republikën e Kosovës për vitin 2021 dhe 2022, krahasuar me vitin paraprak janë të ndërlidhura me zhvillimin ekonomik të vendit dhe mungesës së kuotës vjetore të vendeve të punës me nevojat e tregut, siç është përcaktuar në nenin 68 në Ligjin për të Huaj<sup>10</sup> duke përfshirë mungesën e punëtorëve në profesione të caktuara.

Shtetet më të përfaqësuara me numrin e lejeve të qëndrimit të përkohshëm për arsye punësimi gjatë vitit 2022 janë : Turqi 742 (25%), Shqipëri 691 (23%), Serbi 469 (16%), Maqedoni e Veriut 250 (8.4%), SHBA 192 (6.4%) dhe shtetet e tjera me 632 (21.2%).

<sup>10</sup> Kuota vjetore e punësimit të shtetasve të huaj 1. Me Vendim Qeveria e Republikës së Kosovës e përcakton kuotën vjetore të punësimit të të huajve jo më vonë se deri më 31 tetor për vitin e ardhshëm për vazhdimin e lejeve të lëshuara dhe punësimin e ri. Kuota vjetore e punësimit për të huajt duhet të bëhet publike. 26 2. Propozimin e kuotës vjetore për punësimin e të huajve e harton MPMS-ja në bazë të rekomandimit të Këshillit Ekonomiko-Social.

Figura 5: Numri i vendimeve për lejeqëndrim të përkohshëm me Shqipërinë sipas Marrëveshjes, 2022



Burimi: MPB/DSHAM

Bazuar në të dhënat statistikore, numri i vendimeve pozitive të lëshuara sipas Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për lehtësimin e procedurave dhe kushteve për marrjen e lejeqëndrimit të përkohshëm, për vitin 2022 për qytetarët e Shqipërisë ishte 1,607 vendime pozitive, të cilat janë të paraqitura në Fig.5, nga këto të dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje kemi një rritje të numrit të lejeqëndrimeve të përkohshme për të gjitha kategoritë për këtë vit, kurse numri më i rritur është me arsye të bashkimit familjar dhe qëllime pune, pasi që janë lehtësuar kriteret për lejeqëndrim për shtetas të Shqipërisë dhe saktësisht kjo Marrëveshje ka ndikuar për të legjitimuar qëndrimin e tyre në Republikën e Kosovës.

### **Lejet e qëndrimit të përhershëm**

Gjatë vitit 2022, janë lëshuar gjithsej 230 vendime pozitive për lejeqëndrim të përhershëm. Nga numri i përgjithshëm 230 i vendimeve pozitive për lejeqëndrim të përhershëm, 119 (52%) janë meshkuj, kurse 111 (48%) janë femra.

Arsyet e lëshimit të lejeve të qëndrimit të përhershëm sipas kategorive janë si në vijim: punësim 82 (35.6%), bashkim familjar 62 (27%), lirim nga shtetësia 61 (27%) dhe arsye të tjera 25 (11%).


Shtetet më të përfaqësuara me numrin e lejeve të qëndrimit të përhershëm për arsye punësimi gjatë vitit 2022 janë: Maqedonia e Veriut 30 (37%), Serbia 15 (18%), Shqipëria 11 (13%), Turqia 10 (12%), dhe shtete të tjera 16 (20%).

## Leje pune afatshkurta<sup>11</sup>

Sipas të dhënave në figurën 6, në vitin 2020 kemi një rënie të madhe të numrit të Lejeve të punës afatshkurtër për të huajt, krahasuar me vitet paraprake kjo si pasojë e pandemisë Covid-19, kufizimet e lëvizjes në Kosovë dhe në botë për të parandaluar shpërndarjen e Covid-19, si dhe mbyllja e kufijve.

Bazuar në të dhënat shihet që numri më i madh i të huajve që kanë ardhur në territorin e Republikës së Kosovës për të punuar në një periudhë afatshkurtër deri në 90 ditë brenda periudhës prej 180 ditëve, janë ekspertë të fushave të caktuara, të cilët angazhohen bazuar në marrëveshjet investive dhe projekteve të caktuara afatshkurtëra. Prej tyre janë meshkujt me 88%, ndërsa femra vetëm 12%.

Figura 6: Numri i lejeve të punës afatshkurtër sipas vitit



Burimi: MFPT/APRK

### 3.3. Emigrimi i rregullt

#### *Shtetasit e Republikës së Kosovës me leje të vlefshme qëndrimi në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen*

Gjatë periudhës 2020 - 2022, vendet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen kanë lëshuar rreth 71,240 lejeqëndrime të para<sup>12</sup>, për shtetasit kosovarë.

<sup>11</sup> Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, neni 22, Leja e punës afatshkurtër deri në nëntëdhjetë (90) ditë brenda çdo periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditëve brenda një (1) viti, mund të punojnë të huajt, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>

<sup>12</sup> **Lejeqëndrimi** është çdo autorizim i vlefshëm për të paktën 3 muaj i lëshuar nga autoritetet e një shteti anëtar të BE-së që lejon një shtetas të një vendi të tretë të qëndrojë ligjërisht në territorin e tij. **Leja e parë e qëndrimit** është një leje që i jepet një personi për herë të parë. Leja e qëndrimit konsiderohet si **leje e parë** edhe nëse intervali kohor ndërmjet skadimit të lejes së vjetër dhe fillimit të

Numri i lejeqëndrimeve të lëshuara për herë të parë për shtetasit kosovarë nga autoritetet e shteteve anëtare të BE-së dhe në zonën Schengen, ka pasur një trend rritës që nga viti 2014 për të arritur kulmin në vitin 2019 me rreth 45,670 lejeqëndrimi të para dhe më pas pësoi rënie prej -55% deri në vitin 2022 (20,514), krahasuar me vitin 2019<sup>13</sup>(45,670).

Rritja e numrit të lejeqëndrimit për herë të parë të lëshuar për shtetasit kosovarë, vjen si rezultat i rritjes së numrit të lejeqëndrimit të parë për arsye punësimi. Në vitin 2021, lejeqëndrimi për herë të parë për qëllime punësimi e kalon për rreth 10% numrin e lejeqëndrimit për herë të parë për bashkim familjar (*Figura 7*).

Për shtetasit e Republikës së Kosovës, në fund të vitit 2022 janë lëshuar rreth 20,514 lejeqëndrimi të vlefshme të të gjitha kategorive në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen.<sup>14</sup> Numri i lejeve të vlefshme të qëndrimit të lëshuara, bazuar në të dhënat e Eurostat-it kishte rënie për -9% krahasuar me vitin 2021 (22,746).

Gjatë vitit 2022, 43.7% të të gjitha lejeve të qëndrimit ishin të lidhura me bashkim familjar, 42.6% për qëllim të arsimimit, 2.4% qëllim punësimi, ndërsa lejeqëndrime të klasifikuara për arsye të tjera përbënin 11% të të gjitha kategorive.

Gjatë kësaj periudhe 2020-2022, me lejeqëndrime të vlefshme të shtetasve të Republikës së Kosovës destinacionet kryesore ishin Sllovenia me 18,991 (27%), pasuar nga Gjermania 15,895 (22.3%) Kroacia me 7,763 (11%) , Italia 7,094 (10%), Franca 5,284 (7.4%) kurse nën 10% shpërndarja ishte në shtetet tjera.


---

vlefshmërisë së lejes së **parë** është të paktën 6 muaj, pavarësisht nga viti i lëshimit të lejes. Konventa e lejes së re lidhet me lejet e lëshuara në të gjitha nivelet e shkallës administrative/gjyqësore (p.sh.: shkalla e parë, apelimi, etj.) dhe nga të gjitha autoritetet kombëtare.

<sup>13</sup>[https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/MIGR\\_RESVALID\\_custom\\_7494163/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/MIGR_RESVALID_custom_7494163/default/table?lang=en), Përditësimi i fundit: 11/09/2023 23:00

<sup>14</sup> Shënim: Gjermania ka raportuar 0 në Eurostat numrin e lejeqëndrimeve të lëshuar për shtetasit e Republikës së Kosovës

Figura 7: Emigrantët kosovarë në shtetet e BE-së dhe zonës Schengen, sipas arsyes së qëndrimit



Burimi: Eurostat<sup>15</sup>


### 3.4. Lirimi i shtetësisë së Republikës së Kosovës

Në vitin 2022, nga shtetësia e Republikës së Kosovës janë liruar 4,792 persona, kurse 62 janë refuzuar për mos plotësimin e kriterëve ligjore. Sipas të dhënave në grafik vërejmë se gjatë vitit 2022 kishte një rënie prej 3% të vendimeve pozitive krahasuar me vitin 2021 (4,938), po ashtu rënie kemi edhe të numri i vendimeve negative prej 32%.

Nga 4,792 personat të cilët janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës në vitin 2022 të dhënat tregojnë se 4,211 (88%) janë nga Gjermania, 419 (8.7%) nga Austria, 71 (1.5%) nga Sllovenia dhe 91 (1.8%) nga shtetet e tjera.

<sup>15</sup> <https://ec.europa.eu/eurostat/web/asylum-and-managed-migration/data/database>

Figura 8: Numri i personave që janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës



Burimi: DSHAM

Gjatë tre viteve të fundit, trendet e liritimit nga shtetësia e Republikës së Kosovës kanë qenë në një vijë lineare. Gjatë periudhës 2020-2022 janë liruar 13,363 persona, gjinia mashkullore prin me 6,812 (51%) ndaj gjinisë femërore 6,551 (49 %).



## 4. Migrimi i parregullt

Gjatë vitit 2022, institucionet e Republikës së Kosovës janë përqendruar në zgjerimin e kapaciteteve akomoduese për migrantë dhe refugjatë dhe ka ndërtuar dhe funksionalizuar Qendrën e Përkohshme të Pritjes për Migrantë. Kjo qendër është themeluar me Vendim të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me nr. 0490/2022, të datës 24.06.2022. Arsyet e themelimit të kësaj qendre janë si nevojë për profilizimin dhe referimin e migrantëve.

### 4.1. Politikat dhe legjislacioni

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar politikat dhe kornizën ligjore<sup>16</sup> me qëllim të parandalimit të migrimit të parregullt, luftimit të kontrabandimit me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore.

Gjatë vitit 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Planin e Reagimit për Menaxhimin e Fluksit të Mundshëm të Migrantëve, Refugjatëve dhe Aplikuesve.<sup>17</sup> Strategjia Kombëtare për Migrim 2021-2025 ka parashikuar masat lidhur me parandalimin e migrimit të parregullt, luftimin e kontrabandimit me migrantë, si dhe luftimin e trafikimit me njerëz në mesin e migrantëve.<sup>18</sup>

### 4.2. Imigrimi i parregullt

#### *Refuzimi i hyrjeve*

Gjatë periudhës 2020 - 2022 , numri i përgjithshëm i personave të cilëve iu është refuzuar hyrja në Pikat e Kalimit Kufitar (PKK) është 17,779. Nga të dhënat në tabelë shohim se viti 2021 dhe 2022 prin me numrin më të madh të refuzim-hyrjeve në Pikë Kalimet Kufitare.

---

<sup>16</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Kosovës, (KPK); Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK); Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur; Ligji Nr. 04/L- 076 për Policinë e Republikës së Kosovës; Ligji Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit; Ligji Nr. 04/L-219 për të Huaj dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huaj; Ligji Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit; Ligji Nr.04/L-125 për Shëndetësi; Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2015-2019; Strategjia e punës e DHTQNJ-së dhe Plani Vjetor i Veprimit; Aktet e tjera normative të PK-së, Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 04/2020 për Refuzimin e Hyrjes në Republikën e Kosovës, (Udhëzimet Administrative, Parimet, Procedurat Standarde të Operimit dhe vendimet); Procedurat Standarde të veprimit për viktimat e trafikimit; Standardet minimale për kujdesin ndaj viktimave të trafikimit; Strategjia afatgjate për riintegrimin e viktimave të trafikimit.

<sup>17</sup> Vendimi Nr.14/15 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 23.12.2021.

<sup>18</sup> Vendimi Nr. 10/39 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 13.10.2021.

Tabela 5: Refuzim i hyrjeve në Pikë Kalimet Kufitare

Viti	2020	2021	2022
Numri personave	3,082	7,436	7,261

Burimi: Njësia e Analizës së Rrezikut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit – Policia Kosovës.

Nga numri i përgjithshëm i personave të refuzuar në hyrje të kufirit në vitin 2022, prej tyre 84% janë nga shtetet e rajonit (Ballkanit Perëndimor), nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, 2.8% nga shtetet aziatike, 5.5% nga shtete të tjera janë refuzuar në hyrje 7.7% shtetas të huaj. Arsyet për refuzim të hyrjeve në kufi për shtetasit e vendeve fqinje (Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi), ishte mungesa e dokumenteve të vlefshme ose ndalesat për të hyrë në Republikën e Kosovës, ndërsa për shtetasit e shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen, ishte mungesa e letërnjoftimeve biometrike apo pasaportave. Shtetasve të shteteve aziatike dhe afrikane u është refuzuar hyrja për shkak të mungesës së vizës, mjeteve të pamjaftueshme financiare, mosjustifikimi i qëllimit dhe kushteve të qëndrimit.


### *Kalimi i paautorizuar i kufirit*

Gjatë vitit 2022, numri i imigrantëve të parregullt që kanë kaluar kufirin dhe kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të paautorizuar ka qenë 939, krahasuar me vitin 2021 (1,405) kemi rënie prej -33%, krahasuar me vitin 2020 ( 2,564) kemi rënie për - 63%, dhe krahasuar me vitin 2019 ( 2,027) kemi rënie per -54%

Nga 939 migrantë, 602 (64%) kanë hyrë nga Shqipëria, 252 (27%) kanë hyrë nga Maqedonia e Veriut, 58 (6%) kanë hyrë nga Serbia, 24 (3%) përmes Aeroportit dhe 3 (0.3%) nga Mali i Zi.

Prej këtij numrit të përgjithshëm, 40 migrantë (16 Turqi, 13 Afganistan, 5 Ukrainë, 3 Afrika e Jugut, 3 Jordani ) kanë hyrë në mënyrë të rregullt, 48 (20 Afganistan, 9 Siri, 5 Indi, 5 Marok, 4 Bangladesh, 4 Palestinë dhe 1 Irak) janë zbuluar duke tentuar të futen si klandestinë përmes Pikë Kalimit Kufitar dhe 851 tjerë kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar përmes vijës së gjelbër të kufirit.

Figura 9: Numri i imigrantëve që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar



Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit – Policia e Kosovës

Policia Kufitare, gjatë vitit 2022 ka evidentuar dhe proceduar për veprë penale të kalimit të paautorizuar të kufirit apo vijës kufitare 157 raste.

Në të shumtën e rasteve, të dyshuarit kanë qenë nga vendet fqinje, Shqipëri, Serbi, Maqedoni e Veriut dhe Mali i Zi, dhe arsyet për kalim të parregullt të kufirit, kanë qenë mungesa e dokumenteve të nevojshme për kalim të rregullt të kufirit, apo persona për të cilët është lëshuar paralajmërim për ndalesë hyrje në Kosovë.

### *Shtetasit e huaj me qëndrim të paligjshëm të urdhëruar të largohen vullnetarisht, përfshirë edhe statistikën për kthim të asistuar vullnetar sipas marrëveshjes me IOM-in*


**Qendra e Pritjes së Përkohshme** është themeluar me Vendim të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me nr. 0490/2022, të datës 24.06.2022. Arsyet e themelimit të kësaj qendre janë si nevojë për profilizimin e migrantëve të parregullt nga personat me Mbrojtje Ndërkombëtare.

Kjo qendër është përgjegjëse për pritjen, akomodimin, identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të migrantëve të cenusshëm, si dhe të viktimave të mundshme të trafikimit me qenie njerëzore dhe të miturve të pashoqëruar, informimin dhe pakon e shërbimeve emergjente për migrantët e parregullt të akomoduar në Qendrën e Pritjes së Përkohshme për Migrantë. Pakoja e shërbimeve emergjente e migrantëve të parregullt përfshin: ushqimin, veshëmbathjen sipas

nevojës, pakot higjienike, ofrimin e ndihmës juridike falas, përkujdesjen për ofrimin e ndihmës mjekësore, seanca psikologjike.

Gjatë vitit 2022, që nga Themelimi i Qendrës së Pritjes të Përkohshme për Migrantë janë pritur dhe akomoduar 363 migrantë, nga ky numër 99% janë meshkuj dhe 1% femra.

Figura 10: Numri i të akomoduarve në Qendrën e Pritjes së Përkohshme



Burimi;QPPM/DSHAM

Shtetet që prijnë për nga numri migrantëve ishte Sira 188 (52%), Maroko 77 (21.2%), Palestina 36 (10%), Afganistani 24 (6.6%), Algeria 10 (2.7%) dhe shtete tjera 28 (8%) persona.

**Vendimet për largim vullnetar** - gjatë vitit 2022 janë lëshuar 110 vendime për largim vullnetar nga territori i Republikës së Kosovës, duke shënuar rënie për 4% (114) në krahasim me vitin 2021 dhe 27% (150) në krahasim me vitin 2020.

Numri më i madh i vendimeve për largim vullnetar sipas shteteve ishin për shtetasit e Turqisë me 29 (26.4%), Shqipërisë me 12 (11%) , Serbisë me 6 (5.5%), BeH me 4 (3.6%), Pakistan me 4 (3.6%), kurse 55 (50%) vendime ishin për shtetasit e shteteve tjera. Nga numri i përgjithshëm i vendimeve për largim vullnetar, 62% vendime janë lëshuar për gjininë femërore dhe 38.2% vendime për gjininë mashkullore. Arsytet e lëshimit të vendimeve për largim vullnetar për të huajt me qëndrim të parregullt në Republikën e Kosovës ishin mungesa e lejes së vlefshme të

qëndrimit, anulimi ose revokimi i lejes së qëndrimit, ose janë zënë duke punuar në kundërshtim me dispozitat e parapara me Ligjin për të Huajt ose me ligjet e tjera në fuqi.

***Kthimi i asistuar vullnetar përmes IOM*** - gjatë periudhës 2020-2022, janë kthyer 35 persona të asistuar vullnetarisht nga territori i Republikës së Kosovës. Nga të dhënat e paraqitura në figurën 11, vërejmë se viti 2021 dhe 2022 karakterizohet me numrin më të madh të kthimit vullnetar të asistuar. Kjo vjen si rezultat i gatishmërisë së institucioneve për ta fuqizuar mekanizmin e kthimit vullnetar përmes Marrëveshjes së nënshkruar në mes të MPB-së dhe IOM<sup>19</sup>, për Kthim të Asistuar Vullnetar dhe Riintegrim.

Numri më i madh i vendimeve për largim vullnetarë, gjatë vitit 2022, sipas shteteve ishin për shtetasit e Marokos 5, Jordanisë 4, Filipineve 2, Bullgarisë 2, Austrisë 1, Bosnjë e Hercegovinës 1 dhe Algjerisë 1 vendim.

***Vendimet për largim me forcë*** - gjatë vitit 2022 janë lëshuar 40 vendime për largim me forcë nga territori i Republikës së Kosovës, duke shënuar rënie për 31% (58) në krahasim me vitin 2021 dhe 58% (95) në krahasim me vitin 2020.

Gjatë kësaj periudhe, 67.5% prej tyre u përkasin shtetasve të Shqipërisë, 10% shtetasve të Serbisë dhe 22.5% shtetasve të vendeve të tjera. Edhe gjatë këtij viti, numri më i madh i vendimeve është nxjerrë ndaj gjinisë femërore me 62.5% dhe 37.5% gjinisë mashkullore.


***Dëbimi me vendim gjykatë*** - Drejtoria për Migrim dhe të Huaj me vendim të gjykatave të Kosovës dhe duke u bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në vitin 2022 ka dëbuar nga Republika e Kosovës 13 persona. Krahasuar me vitin 2021 është shënuar rënie për 61% (33 dëbime). Nga këto dëbime, 4 shtetas nga Maqedonia e Veriut, 3 nga Turqia, 2 nga Jordania dhe me nga 1 shtetas vijojnë Italia, Maroku, Tunizia dhe Shqipëria.

Në figurën 11, është paraqitur numri i shtetasve të huaj me qëndrim të paligjshëm të urdhëruar të largohen në vend të origjinës vullnetarisht, të asistuar nga IOM, me forcë dhe me vendim gjykatë.

---

<sup>19</sup> Marrëveshja e nënshkruar në mes të MPB-së dhe IOM, në Maj të vitit 2019

Figura 11: Numri i vendimeve për largim vullnetar, vullnetar IOM, me forcë dhe me vendim gjykatë




Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar, Policia e Kosovës.

### Luftimi i kontrabandimit me migrantë

Policia e Kosovës ka vazhduar kontrollet sistematike dhe të hollësishme në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar dhe përgjatë Vijës së Gjellbër të Kufirit, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kontrabandimit me migrantë. Po ashtu, janë luftuar edhe grupet e organizuara kriminale brenda territorit të Republikës së Kosovës të cilët janë marrë me kontrabandë me migrantë.

Figura 12: Rastet e iniciuara të kontrabandës me migrantë



Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar, Policia e Kosovës.

Gjatë vitit 2022, numri i rasteve të iniciuara për veprën penale të kontrabandimit me migrantë nga Policia e Kosovës ishte 37 raste, krahasuar me vitin 2021 (30 raste), krahasuar me vitin 2020 (25 raste).

*Tabela 6: Numri i të dyshuarit për kontrabandë me migrantë sipas shtetësisë*

Shtetësia	2020	2021	2022
KOSOVË	27	52	49
SHQIPËRI	4	1	3
SERBI	2	2	0
TURQI	1	1	3
MAQEDONI E V.	0	3	3
SIRIA	0	1	6
IRAK	0	1	0
ALGJERI	0	2	0
PALESTINË	0	2	0
LIBAN	0	1	0
JORDANI	0	1	0
AFGANISTAN	0	0	1
<b>Gjithsej</b>	<b>34</b>	<b>67</b>	<b>65</b>

*Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar, Policia e Kosovës.*

Numri i personave të dyshuar të kontrabandimit me migrantë gjatë vitit 2022 ishte 65, krahasuar me vitin 2021 ishte 67, krahasuar me vitin 2020 ku kishim 34 të dyshuar. Nga 65 persona të dyshuar për kontrabandë me migrantë, 49 ishin shtetas të Republikës së Kosovës, 10 ishin shtetas të shteteve aziatike, 3 shtetas të Maqedonisë së Veriut, 3 të Shqipërisë. Nga 65 persona të dyshuar, Njësia e Hetimeve ka arritur të bëjë arrestimin e 61 prej tyre.

Tabela 7: Numri i viktimave të evidentuara të kontrabandimit me migrantë sipas shtetësisë 2022<sup>20</sup>

SHTETET	Nr. i viktimave të evidentuara
SIRI	226
AFGANISTAN	34
KOSOVË	18 <sup>21</sup>
EGJIPT	15
BANGLADESH	11
IRAK	9
JEMEN	6
SUDAN	6
PALESTINË	5
IRAN	4
ALGJERI	2
MAROK	2
BOSNJA DHE HERCEGOVINA	1
<b>Gjithsej</b>	<b>339</b>

Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës.

### Trafikimi me qenie njerëzore

Të dhënat tregojnë se gjatë këtyre viteve 2020-2022 janë identifikuar 3 viktima të trafikimit (e huaj). Të gjitha viktimave u janë ofruar shërbimet siç parashihen në PSO për Viktima të Trafikimit.

Tabela 8: Numri i viktimave të trafikimit sipas shtetësisë

Viktima të trafikimit të identifikuar/ origjina	2020	2021	2022	Gjithsej
SHQIPËRI	0	1	1	2
SERBI	0	0	1	1
<b>Gjithsej</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>

Burimi: Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Njerëz, Policia e Kosovës.

<sup>20</sup> Të dhënat për këtë kategori kanë filluar të gjenerohen nga viti 2022

<sup>21</sup> Ky numër i referohet viktimave të kontrabandimit nga Kosova me destinacion vendet evropiane



Tabela 9: Numri i inspektimeve, Planet Operative, Operacionet Policore të realizuar gjatë viteve

Viti	Plane Operative	Operacione Policore	Lokale të inspektuara/Kontrolluara
2020	14	46	77
2021	38	88	168
2022	41	96	194

Burimi: Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Njerëz, Policia e Kosovës.

### 4.3. Emigrimi i parregullt

Kjo pjesë ofron të dhëna dhe statistika për shtetasit kosovarë: të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufijtë e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, të cilët u gjenden me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen dhe të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhrit për largim.

Në periudhën 2020 – 2022, rreth 4,825 shtetas kosovarë iu është refuzuar hyrja në kufijtë e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, rreth 13,950 shtetas kosovarë janë gjetur në mënyrë të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, rreth 12,635 shtetas të Republikës së Kosovës u urdhëruan të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen dhe rreth 3,985 shtetas kosovarë u larguan nga territoret e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, pas një urdhri për t'u larguar.

#### *Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose janë zënë në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen*

Numri i përgjithshëm i shtetasve të Republikës së Kosovës që u refuzuan<sup>22</sup> ose u zunë në kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të BE-së dhe Zonës Schengen<sup>23</sup> në vitin 2022, ishte rreth 1,860 persona, krahasuar me vitin 2021 (1,710) kishte rritje prej 9%.

Gjatë vitit 2022 nga numri i përgjithshëm i refuzimeve të regjistruara për shtetasit kosovarë, ngjajshëm sikurse vitin paraprak, persona që u refuzuan të hynë në kufijtë e Kroacisë ishin 715 (38.4%) , Sllovenisë 405 (29%), Hungarisë 230 (12.4%) , Gjermanisë 140 (7.5%) dhe shtetet tjera me 370 (20%) .

<sup>22</sup> Çdo person llogaritet vetëm një herë brenda periudhës së referencës, pavarësisht nga numri i refuzimeve të dhëna për të njëjtin person.

<sup>23</sup> Personat të cilëve u refuzohet hyrja në kufirin e jashtëm të BE-së për shkak se nuk përmbushin të gjitha kushtet e hyrjes të përcaktuara në nenin 6 (1) të Kodit të Kufijve të Schengenit dhe nuk i përkasin asnjë prej kategorive të njerëzve të përmendur në nenin 6 (5). të kësaj Rregulloreje.

Arsyet kryesore për refuzimin e hyrjes në kufijtë e jashtëm të BE-së dhe zonës Schengen, ishin se nuk mund të justifikonin arsyen e një vize apo qëndrimi të vlefshëm, personi konsiderohej si një kërcënim publik, kishin dokumente të udhëtimit të falsifikuara, nuk kishin dokumente të vlefshme, kishin vizë apo lejeqëndrimi të falsifikuar, mjetet e pamjaftueshme të jetesës dhe personi ka qëndruar tashmë 3 muaj në një periudhë 6 mujore.

Shumica dërmuese prej 84% e shtetasve të Republikës së Kosovës, të cilëve iu refuzua hyrja në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, u ndaluan në kufijtë e jashtëm tokësor, përqindja e refuzimeve në kufijtë ajror ishte 14%, ndërsa vetëm një pjesë e vogël 2% e refuzimeve ishin në kufijtë detarë (kryesisht në kufij me Italinë).

### *Shtetasit kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen*

Shtetasit kosovarë që kanë kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme dhe që nuk kanë pasur të drejtë të qëndrojnë në territorin e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen<sup>24</sup>, për vitin 2022, ishte gjithsej 5,025 persona<sup>25</sup>, krahasuar me vitin 2021 (4,405), kishte ngritje prej 14%.

Shtetet Anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, që raportuan numër më të madh të shtetasve kosovarë me qëndrim të parregullt në vitin 2022, ishin: Gjermania 1,660 (33%), e pasuar nga Zvicra 1,035 (21%), Kroacia 540 (11%), Franca 425 (8.5%), Austria 340 (7%), Italia 305 (6%), Hungaria 280 (5.6%), Sllovenia 250 (5%) dhe shtetet tjera 190 (3.8%). Vetëm në dy shtetet anëtare të BE-së (Gjermani dhe Zvicër) me qëndrim të parregullt u kapën më shumë se gjysma 2,695 (54%) të shtetasve kosovarë.

Gjysma e shtetasve kosovarë rreth 50%, janë gjetur dukë hyrë në formë të parregullt (ilegale) në territorin e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, me mbi qëndrim ishin 19% dhe arsye tjetër 31%. Në dy vitet e fundit, Kroacia raportoi numrin më të madh të shtetasve kosovarë që hynë në mënyrë të parregullt me 27%, e pasuar nga Zvicra me 26%, Italia 13%, Sllovenia 12%, Gjermania 12% dhe shtetet tjera me 10%.

---

<sup>24</sup> Kjo kategori lidhet me personat që janë gjetur se kanë hyrë në mënyrë të paligjshme (për shembull duke shmangur kontrollet e imigracionit ose duke përdorur një dokument mashtrues) dhe ata që mund të kenë hyrë në mënyrë të ligjshme, por më pas kanë mbetur në baza të paligjshme (për shembull, duke e tejkaluar lejen e tyre për të qëndruar ose duke marrë punë të pa-autorizuar). Në këto statistika regjistrohen vetëm personat që janë kapur ose përndryshe vihen në vëmendjen e autoriteteve të shteteve të imigrimit

<sup>25</sup> [https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr\\_eipre&lang=en](https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_eipre&lang=en), përditësimi i fundit më, 11.05.2023

### *Shtetasit kosovarë me qëndrim të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen me urdhër për largim<sup>26</sup>*

Në vitin 2022, numri i përgjithshëm i shtetasve kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen ishte 4,255. Numri i përgjithshëm i kësaj kategorie vazhdon të bjerë në vazhdimësi që nga viti 2015, mirëpo në vitin 2022 pati një rritje të lehtë , prej rreth 2.6%, në krahasim me vitin 2021 (4,090).

Numri i përgjithshëm i urdhër largimeve të shtetasve kosovarë nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen në vitin 2022 sipas shteteve u regjistruan në: Francë 1,175 (27.6%), Slloveni 935 (22%), Kroaci 560 (13.2%), Zvicra 290 (6.8%), Itali 270 (6.3%), dhe shtetet tjera 1,025 (24.1%).

### *Shtetasit kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhrit për largim*


Në vitin 2022, numri i përgjithshëm i personave të kthyer si shtetas kosovarë, të cilët u larguan në bazë të një urdhëri për largim nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen, ishte 1,395. Ky numër krahasuar me vitin 2021 që ishte 1,415, shënon një rënie të vogël prej rreth 1%.

Nga numri i përgjithshëm i shtetasve kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhrit për largim në vitin 2022, nga Kroacia ishin 445 (32%), Gjermani 260 (19%), Suedi 205 (15%), Francë 140 (10%), Austri 130 (9.3%) dhe shtetet e tjera me 215 (15.4%).

---

<sup>26</sup> Kjo kategori përfshin shtetasit e vendeve të treta që gjenden në mënyrë të paligjshme, të cilët i nënshtrohen një vendimi ose akti administrativ ose gjyqësor që deklaron se qëndrimi i tyre është i paligjshëm dhe që vendos detyrimin për t'u larguar nga territori i Shtetit Anëtar. Këto statistika nuk përfshijnë personat që transferohen nga një shtet anëtar në tjetrin sipas mekanizmit të vendosur nga Rregullorja e Dublinit, por mbledhen nga Eurostat sipas statistikave të Dublinit. Çdo person llogaritet vetëm një herë brenda periudhës së referencës, pavarësisht nga numri i njoftimeve të dhëna për të njëjtin person.

Figura 13: Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi, janë zënë me qëndrim të parregullt janë urdhëruar të largohen dhe janë larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen



Burimi: Eurostat

## 5. Ripranimi dhe riintegrimi

Ky kapitull përfshin një përmbledhje të procesit, kthimin e shtetasve të Republikës së Kosovës, si dhe riintegrimin e integrimin e të huajve në shoqëri.

### 5.1. Politikat dhe korniza ligjore / ripranimi

Ligji për Ripranim përcakton rregullat dhe procedurat për ripranimin e një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaj, i cili nuk i plotëson kushtet për hyrje ose qëndrim në territorin e shtetit kërkues. Zbatimi i legjislacionit për ripranim ka përparësi në aspektin e bashkëpunimit për ripranimin me vendet me të cilat Kosova ende nuk ka nënshkruar një marrëveshje dypalëshe për ripranim.

Gjatë vitit 2022 ka vazhduar zbatimi i Ligjit Nr. 03/1 - 208 për Ripranim, si dhe marrëveshjeve të ripranimit.

Deri në vitin 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshje ripranimi me 24 vende<sup>27</sup>, 20 prej të cilave janë vende anëtare të BE-së dhe vendet e Schengenit.

#### *Statistikat*

Në vitin 2022 janë ripranuar rreth 613 persona<sup>28</sup>, me forcë 536 (87 %) <sup>29</sup>, vullnetarë 13 (2%) dhe vullnetar të asistuar nga IOM 64 (10%)<sup>30</sup>, pra kemi rënie prej 28% krahasuar me vitin 2021 që kishte rreth 848 persona të ripranuar, me forcë 710 (84 %) vullnetarë 45 (5%) dhe vullnetar të asistuar nga IOM 93 (11%) të shtetasve të Republikës së Kosovës.

Në bazë të dhënave vjetore, sipas strukturës gjinore dhe moshës, nga shtetasit kosovarë të ripranuar me forcë gjatë vitit 2022, 470 (87.6%), janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 66 (12.3%) të gjinisë femërore. Të ripranuar vullnetarë gjatë vitit 2022, 6 (46%) janë të gjinisë mashkullore dhe 7 (53 %) të gjinisë femërore.

---

<sup>27</sup> Ligji Nr.03/L-208 për Ripranim, 2009 Republika e Shqipërisë, 2009 Republika e Francës, 2010 Këshilli Federal Zvicëran, 2010 Republika Federale e Gjermanisë, 2010 Mbretëria e Danimarkës, 2010 Republika e Austrisë, 2010 Mbretëria e Norvegjisë, 2011 Republika e Sllovenisë, 2011 Beneluxi (Belgjikë, Holandë dhe Luksemburg), 2011 Republika e Çekisë, 2011 Mali i Zi, 2011 Mbretëria e Suedisë, 2011 Republika e Finlandës, 2012 Republika e Hungarisë, 2012 Republika e Bullgarisë, 2012 Republika e Maltës, 2013 Republika e Estonisë, 2013 Principata e Lihtenshtajnit, 2013 Republika e Kroacisë, 2014 Republika e Italisë, 2015 Republika e Turqisë dhe 2017 Republika e Maqedonisë së Veriut.


<sup>28</sup> Numri i të ripranuarve me forcë dhe vullnetarë është llogaritur në bazë të ripranuarve me forcë sipas të dhënave të DSHAM-së, ndërsa në bazë të dhënave të ripranuarve vullnetarë të asistuar nga IOM për vitin 2022.

<sup>29</sup>Burimi: MPB

<sup>30</sup>Burimi: IOM

Ndërsa sipas të dhënave nga IOM, të ripranuarit vullnetarë gjatë vitit 2022, 41 (64%), janë të gjinisë mashkullore dhe 23 (36%), janë të gjinisë femërore.

Figura 14: Ripranimi vullnetar dhe me forcë



Burimi: DSHAM, IOM

Në bazë të dhënave në figurën 14 , si të ripranuarit me forcë, ashtu edhe ata vullnetarë IOM, vërehet se grupmoshat 35-64 (266 ose 43.4%) dhe 18-34 (242 ose 39.5%) janë me numër më të madh të ripranuarve, ndërsa grupmoshat tjera me 105 ose 17%. Në bazë të moshës shkollore (6-17) vjeç, numri i të ripranuarve i kësaj moshe për vitin 2022 është 94 ose 15.3 %.

Sipas të dhënave vjetore për vitin 2022 (613), numri më i madh i të ripranuarve (me forcë, vullnetarë dhe vullnetarë të asistuar), janë nga Gjermania 304 (50%), Zvicra 112 (18.3%), Suedia 54 (9%) , Franca 32 (5.2%) ,Austria 26 (4.2%) dhe shtete të tjera me 85 (14%). Ndërsa për vitin 2021 (848), numri më i madh i të ripranuarve (me forcë, vullnetarë dhe vullnetarë të asistuar), janë nga Gjermania 450 (53%), Zvicra 140 (17%), Franca 72 (8%) dhe shtete të tjera me 186 (22%).

Nga këto dhëna mund të shohim se trendi i ripranimit gjatë tre viteve të fundit (2020-2022) është në rënie. Gjatë periudhës 2009-2022 gjithsej të ripranuar (me forcë, vullnetarë dhe të asistuar vullnetar IOM) është 70,796 prej tyre janë kthyer me forcë 41,562 (58.7%), vullnetarë 9,717(13.7%) dhe vullnetarë IOM 19,517 (27.6%).

Rreth 94% e rasteve të ripranimit u trajtuan në bazë të marrëveshjeve dypalëshe të ripranimit me vendet anëtare të BE-së, 5% e rasteve të ripranimit u bazuan në marrëveshjet dypalëshe të

ripranimit me vendet jo anëtare të BE-së, ndërsa më pak se 1% e rasteve të ripranimit u trajtuan në përputhje me Ligjin për Ripranim.


## 5.2. Politikat dhe korniza ligjore / riintegrimi

Politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e migrimit dhe riintegrimin të personave të riatdhesuar, janë të përcaktuara me Strategjinë Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë 2018-2022, Strategjinë Shtetërore për Migrim 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2023, si dhe Rregulloren QRK Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.<sup>31</sup>

### Statistikat

Gjatë periudhës 2020-2022, në kuadër të skemave të ndryshme emergjente janë mbështetur personat e riatdhesuar sipas statistikave në vijim:

Figura 15: Ndhimja menjëherë pas arritjes dhe ndihmat emergjente brenda 12 muajve pas riatdhesimit




Burimi: DRPRIH/MPB/Institucionet Vendore dhe Organizatat Ndërkombëtare

Në figurën 15, nga skemat për Riintegrim përgjatë vitit 2022, vërehet që skema në të cilën kanë përfituar numri më i madh i personave të riatdhesuar është skema e akomodimit me qira deri në 12 muaj. Po ashtu, vërehet që të skema *Pako ushqimore dhe higjienike/asistenc sociale*, kemi një numër të konsiderueshëm të përfituesve të riatdhesuar që kanë përfituar nga kjo skemë duke e krahasuar me skemat e tjera.

<sup>31</sup> <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40273>  
<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41097>

Figura 16: Ndihma për riintegrim të qëndrueshëm



Burimi: DRPRIH/MPB/Institucionet Vendore dhe Organizatat Ndërkombëtare

Në kuadër të skemave për riintegrim të qëndrueshëm, gjatë periudhës 2022 vërehet që numri me i lartë i personave të riatdhesuar kanë përfituar nga skema *shërbimet e konsulencës*. Po ashtu, vërehet një rritje e përfitueseve të riatdhesuar në skemën e *financim biznesi (vetëpunësim)*.



## 6. Integrimi i të huajve

Qeveria e Republikës së Kosovës sipas Vendimeve të Qeverisë Nr.10/68 dhe Nr. 9/94, gazetarët nga Ukraina po financon programin “Journalists in Residence - Kosovo” në kuadër të cilit gjatë vitit 2022 ka strehuar 13 gazetarë nga Ukraina.

### 6.1. Politikat dhe korniza ligjore


Korniza kryesore ligjore që rregullon integrimin e të huajve në Republikën e Kosovës është Rregullorja (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve e cila përcakton bazën e ndërtimit të sistemit të integrimin të të huajve në Republikën e Kosovës.

#### *Fitimi i shtetësisë së Republikës së Kosovës*

Divizioni për Shtetësi, në kuadër të DSHAM-së, në vitin 2022 ka pranuar 1,059 kërkesa për fitim të shtetësisë së Republikës së Kosovës, ndërsa 587 persona kanë fituar shtetësinë, si dhe 538 janë refuzuar për mosplotësimin e kriterëve ligjore. Krahasimi i të dhënave të viteve 2021/2022 tregon se në vitin 2022, ka rritje të vendimeve pozitive prej 39%, ndërsa vendimet negative janë në një vijë lineare.

Nga 587 personat, të cilët kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës në vitin 2022, 165 (28%) janë shtetas të Serbisë, 56 (9.5%) Maqedoni e Veriut , 44 (7.5%) Shqipërisë dhe 322 (55%) me shtetësi të tjera.


Figura 17: Numri i personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës



Burimi: DSHAM

Gjatë tre viteve të fundit, trendet e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës tregojnë ngritje. Gjatë periudhës 2020-2022 kanë fituar shtetësinë 1,185 persona, prin gjinia femërore me 627 (53%) ndaj gjinisë mashkullore 558 (47%).

Figura 18: Numri i vendimeve pozitive për fitim të shtetësisë së R. Kosovës me dekret presidencial



Burimi: Zyra Presidenciale

Në figurën 18, janë të paraqitura të dhënat e fitimit të shtetësisë së R. Kosovës me dekret presidencial. Nga këto të dhëna vërejmë se nga 29 vendime me dekret presidencial, ka pas rënie të vendimeve sa i përket gjinisë femërore 9 (31%) gjatë kësaj periudhe krahasuar me gjininë mashkullore 20 (69%).


### Skema e integritit të të huajve

Gjatë vitit 2022, kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare 24 azilkërkues, 4 persona kanë përfituar statusin e refugjatit, ndërsa 4 persona kanë fituar statusin e mbrojtjes plotësuese dhe 16 persona mbrojtje të përkohshme.

Gjatë vitit 2020-2022<sup>32</sup>, në kuadër të skemave të ndryshme për integrim janë mbështetur personat e huaj, numri i të cilëve është i paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

<sup>32</sup> Statistikat reflektojnë peirudhën kohore 2020-2022, kur edhe ka filluar ofrimi i shërbimeve nga DRPRIH

Figura 19: Numri i personave të cilat kanë përfituar nga skemat e integrimit



Burimi: DRPRIH/MPB

Po ashtu, gjatë këtij viti janë organizuar testet e vlerësimit të integrimit për 227 të huaj, prej tyre 30 persona kanë aplikuar për lejeqëndrim të përhershëm, si dhe 197 persona kanë aplikuar për fitim të shtetësisë në Republikën e Kosovës.

## 7. Migrimi dhe zhvillimi


Në këtë kapitull pasqyrohen politikat dhe strategjitë zhvillimore të Republikës së Kosovës që ndërlidhen me migrimin dhe zhvillimin. Fokusi është vënë në prezantimin e mënyrave se si mund të përdoret potenciali i migrimit për qëllime zhvillimore, dërgesat (remitancat) dhe investimet nga diaspora, si dhe politikat e angazhimit të kthimit të ekspertëve nga diaspora (kthimi i dijes).

### Statistikat

#### 7.1. Dërgesat e emigrantëve (remitancat)

Remitancat në përgjithësi kanë ndikim të shumëfishtë në aspektet kryesore të zhvillimit në Kosovë. Të hyrat nga dërgesat e emigrantëve janë në rritje si rezultat i trendit të rritjes së emigrimit të rregullt për qëllime të punësimit. Në vitin 2022, remitancat në Kosovë arritën shumën prej 1,223.8 miliardë euro krahasuar me vitin 2021, ku remitancat arritën vlerën 1,153.4 miliardë. Dërgesat e emigrantëve në vitin 2022 kanë pasur pjesëmarrje prej 13.66% në bruto produktin vendor (BPV).

Figura 20: Të hyrat nga remitancat



Burimi: BQK, 2022


Rreth 74.2% e dërgesave të emigrantëve gjatë vitit 2022 janë transferuar përmes sistemit financiar, ndërsa pjesa tjetër përfshin dërgesat e emigrantëve në mallra dhe mjete të tjera që transferohen përmes kanaleve joformale. Burimet kryesore të dërgesave të emigrantëve

vazhdojnë të jenë nga Gjermania me 38.5% dhe Zvicra me 19.8% të totalit të dërgesave të pranuar në Kosovë duke pasuar me SHBA-të me 8.6%, Austria me 5.5% dhe Italia me 4.9%, dhe Franca me 4.0%.

## 7.2. Investimet e huaja direkte

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë për vitin 2022 arrijnë vlerën prej 778.2 milionë euro, apo 85% më shumë sesa në vitin paraprak. Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur trendi i IHD-ve në Kosovë gjatë periudhës 2020-2022.

Figura 21: Investimet e huaja direkte në Kosovë të shprehura në miliona euro dhe si përqindje e BPV-së



Burimi: BQK,


Sektorët që kanë pasur trend pozitiv krahasuar me vitin paraprak dhe kanë ndikuar në rritjen e investimeve gjatë vitit 2022 janë sektorët e patundshmërisë, financiar, sektori i xehetarisë, sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar dhe ai i ndërtimit. Pjesëmarrja e patundshmërisë në gjithsej investimet direkte në Kosovë në vitin 2022 ishte 67.3%, (523.7 milion euro) aktivitetet financiare me 6.9% (53.9 milion euro), xehetarisë me 6.7% (52.4 milion euro), sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar me 5.8% (44.9 milion euro) dhe ai i ndërtimit me 3.4% (26.7 milion euro).

## 7.3. Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve në Kosovë / Turizmi i diasporës në Kosovë

Kosova gëzon turizëm të konsiderueshëm nga diaspora, veçanërisht gjatë pushimeve sezonale të verës dhe dimrit. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit janë rritur vazhdimisht që nga viti 2010,

duke arritur në 1,875.3 milion euro në vitin 2022. Gjatë vitit 2020 për arsye të pandemisë dhe mbylljes totale për disa muaj, vlera e turizmit ka rënë për 52.5%, duke shënuar vlerën 628.0 milion euro. Ndërsa pas heqjes së restriksioneve të pandemisë në vitin 2021, vlera e turizmit pati rritje të theksuar prej 137.3%. Në vitin 2022 ka arritur në shumën prej 1,875.3 miliardë euro, që paraqet një rritje prej 25.8% krahasuar me vitin paraprak. Pjesa dominuese e të ardhurave të kësaj kategorie, rreth 95% i atribuohet diasporës.


Figura 22: Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve



Burimi: BQK,

Rëndësia e diasporës mund të shihet edhe nga përqindja e pjesëmarrjes në bruto produktin vendor ku remitancat përbëjnë rreth 13.7% të BPV-së, shërbimet e udhëtimit të diasporës përbëjnë 19.9% dhe nga përqindja e pjesëmarrjes së IHD-ve në patundshmëri me 5.3%, siç është paraqitur në Figurën 23. Duke pasur parasysh se shumica e këtyre tre komponentëve përbën rreth 39% të bruto produktit vendor, të hyrat përkatësisht nga migrimi janë faktor i rëndësishëm për të mundësuar konsumin e brendshëm të vendit (konsumi plus investimet) dhe për të ndihmuar në ngritje të prodhimit vendor.

Figura 23: Të hyrat e përgjithshme nga Diaspora



Burimi: BQK,

## 8. Mbrojtja Ndërkombëtare

Divizioni për Azil /DSHAM, është autoriteti përgjegjës për zhvillimin e procedurës së azilit. Procedura e azilit në Kosovë është rregulluar me Ligjin Nr. 06/L-026 për Azil, i cili rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, personave me status refugjati, si dhe personave të cilëve iu është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme.

### 8.1. Politikat dhe legjislacioni

Gjatë vitit 2022, janë hartuar aktet nënligjore dhe dokumente udhëzuese në fushën e azilit, si në vijim:

- Është miratuar Vlerësimi Ex-post i Ligjit Nr.06/L-026 për Azil;
- Është miratuar Udhëzuesi për Parandalimin, Menaxhimin e Riskut dhe Përgjigjen ndaj Dhunës Bazuar në gjini në kontekst të migracionit të përzier.

### 8.2 Azilkërkuesit në Kosovë / Statistikat

Në vitin 2022, në Republikën së Kosovës, kishte 550 aplikues për mbrojtje ndërkombëtare prej tyre 504 (91.6%) meshkuj dhe 46 (8.3 %) femra.

Shteti që prin për nga numri aplikuesve është Maroku me 186 (34%), i pasuar nga Siria me 175 (32%), Afganistani me 46 (8.3%), Algjeri 23 (4.1%), Turqi 22 (4.2%), Egjipt 20 (3.6%), Palestinë 16 (3%) dhe shtetet tjera<sup>33</sup> me 62 (11.2%).

Numri i lartë i kërkesave për azil nga shteti i Marokut sipas një analize të shkurtër është rezultati i gjendjes jostabile ekonomike dhe këtë e vërtetojnë deklaratimet e aplikuesve, pasi që në aplikacione kanë theksuar arsyen ekonomike që kanë ndikuar për lëshimin e vendit të origjinës.


Po ashtu grupmosha më e përfaqësuar është 18-34 me 413 (75 %) persona, grup mosha 35-64 me 69 (12.5%), grupmosha 0-13 me 36 (6.5%), grupmosha 14-17 me 31 (5.6%) dhe grupmosha 65+ me 1 person.

---

<sup>33</sup> [Rap.i shkurter vjetor 2022 ALB..pdf \(rks-gov.net\)](#)



Figura 24: Numri i azilkërkueseve sipas viteve



Burimi: DSHAM/MPB

Nga numri i përgjithshëm i aplikueseve për mbrojtje ndërkombëtare për vitin 2022, persona të rritur ishin 485 (88.1%), fëmijë 42 (7.6%) dhe 23 (4.2%) fëmijë të pashoqëruar.

Sipas gjinisë, dominon gjinia mashkullore me 501 (91%), përderisa gjinia femërore përfaqësohet me 48 (8.7%).

Tabela 10: Numri i vendimeve sipas statusit për vitin 2022

SIPAS STATUSIT TË VENDIMIT	NR.VENDIMEVE
Ndërprerje të procedurës	459
Ndërprerje e procedurës vullnetare	24
Mbrojta e përkohshme	16
Vendimi refuzim	11
Status refugjati	4
Mbrojtje plotësuese	4
Refuzimi sipas procedurës së përshpejtuar	3
<b>Gjithsej</b>	<b>521</b>


Burimi: DSHAM/MPB

Sipas këtyre të dhënave stoku më i madh i kërkesave për azil është në ndërprerje të procedurës për arsye të panjohura për autoritetet vendimmarrëse për këtë status. Sipas përvojës së kaluar Kosova ende shfrytëzohet si vend transit për azilkërkues, njëkohësisht edhe për trafikantët si mundësi për të kaluar nga vendet aziatike në shtetet e Evropës Perëndimore.

### 8.3 Azilkërkuesit Kosovarë në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen

Në vitin 2021, numri i aplikuesve Kosovarë për herë të parë<sup>34</sup> për azil, në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, ishte 2,495<sup>35</sup> persona. Krahasuar me numrin e përgjithshëm të aplikuesve për azil<sup>36</sup> 3,195, për 700 ose 28% më i ulët. Të dhënat për numrin e aplikuesve për herë të parë në vitin 2022 (2,495), tregojnë se kishte ngritje prej rreth 52%, krahasuar me vitin 2021 (1,640 persona). Sipas të dhënave për dy vitet e fundit 2021 dhe 2022, gjithsej 1,415 shtetasve kosovarë kanë bërë një aplikim të mëvonshëm për azil.

Figura 25: Azilkërkuesit kosovarë në shtetet e BE-së dhe të zonës Schengen



Burimi: Eurostat

Azilkërkuesit kosovarë që konsiderohen të mitur të pashoqëruar<sup>37</sup>, në periudhën 2020-2022, kishte gjithsej 85 aplikime në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen. Gjatë kësaj periudhe numri më i madh i aplikimeve për azil nga të miturit e pashoqëruar<sup>38</sup> u regjistrua në

<sup>34</sup> Aplikanti për herë të parë për mbrojtjen ndërkombëtare (i përkufizuar nga neni 2(h) dhe 2(i) të Direktivës së Kualifikimit 2011/95/EU) është një person që ka depozituar një aplikim për azil për HERË TË PARË në një Shtet Anëtar të caktuar. Shprehja “herë të parë” nuk nënkupton afate kohore dhe prandaj një person mund të regjistrohet si aplikant për herë të parë vetëm nëse ai ose ajo nuk ka aplikuar asnjëherë për mbrojtje ndërkombëtare në shtetin raportues në të shkuarën, pavarësisht faktit që ai rezulton se ka aplikuar në Shtet tjetër Anëtar të Bashkimit Europian.

<sup>35</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/MIGR\\_ASYAPPCTZA/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/MIGR_ASYAPPCTZA/default/table?lang=en), përditësimi i fundit, 02/06/2023 23:00

<sup>36</sup> Aplikant për azil i referohet një shtetasi të një vendi të tretë ose personi pa shtetësi që ka depozituar një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare ose që është përfshirë në një aplikim të tillë si anëtar i familjes në lidhje me të cilin nuk është marrë akoma një vendim përfundimtar gjatë periudhës së referencës.

<sup>37</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/MIGR\\_ASYUNAA/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/MIGR_ASYUNAA/default/table?lang=en), përditësimi i fundit, 16/05/2023 23:00

<sup>38</sup> I mituri i pashoqëruar është një person nën moshën 18 vjeç, i cili arrin në territorin e një Shteti Anëtar të BE-së, dhe është i pashoqëruar nga një i rritur përgjegjës për të miturin ose një i mitur i cili mbetet i pashoqëruar pasi të ketë hyrë në territorin e një Shteti Anëtar të BE-së.

vitin 2021 30) dhe në vitin 2022 (20). Kryesisht dominonte gjina mashkullore me 89% krahasuar me atë femrore 11%. Shtete anëtare të BE-së që regjistruan numrin më të madh të aplikimeve nga të miturit e pashoqëruar kosovarë ishin: Sllovenia 53%, Suedia 23% dhe shtetet tjera me 6%.

Destinacioni i aplikuesve për herë të parë të shtetasve kosovarë gjatë vitit 2022, ishte në Franca me 1,415 (57%), aplikues të regjistruar shtet i cili mbetet destinacioni kryesor edhe në vitet paraprake. Destinacioni i radhës ishte Italia 530 (21.2%), Gjermania 230 (9.2%), Belgjika 85 (3.4%), Zvicra 45 (1.8%) dhe shtetet tjera me 165 (6.6%).

### *Aplikimi i mëvonshëm*

Duke filluar nga viti 2021, Eurostat për herë të parë mbledh statistika për aplikuesit e mëvonshëm (persona që riaplikuan për azil pasi ishte marrë një vendim për një aplikim të mëparshëm)<sup>39</sup>.

Sipas të dhënave për dy vitet e fundit 2021 dhe 2022, gjithsej 1,415 shtetasve kosovarë kanë bërë një aplikim të mëvonshëm për azil.

### *Kërkesat për azil në Mbretërinë e Bashkuar*

Të dhënat për numrin e azilkërkuesve në Mbretërinë e Bashkuar<sup>40</sup> që nga viti 2020, nuk publikohen në bazat e të dhënave të EUROSTAT-it.

Numri i kosovarëve që bënë një kërkesë për azil në Mbretërinë e Bashkuar, gjatë viteve 2020 - 2022, ishte gjithsej 82 persona. Sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se kryesisht meshkujt përbënin rreth 83%, të atyre që kishin bërë një kërkesë për azil në krahasim me gjininë femrore e cila përbënte 13%. Sipas moshës kryesonte grupmosha 30-49 vjeç me 49%, 18-29 vjeç me 45%, nën moshën 18 vjeç me 4% dhe 50-69 vjeç 2%.


Figura 26 tregon numrin e vendimeve fillestare për azilkërkuesit kosovarë në Mbretërinë e Bashkuar në përqindje. Gjatë periudhës referuse për azilkërkuesit kosovarë në Mbretërinë e Bashkuar u nxorrën 30 vendime fillestare për azilin. Gjysma e kërkesave për azilkërkuesit

<sup>39</sup> **Aplikimi i mëvonshëm** - nënkupton një kërkesë të mëtejshme për mbrojtje ndërkombëtare e bërë pasi është marrë një vendim përfundimtar për një aplikim të mëparshëm, duke përfshirë rastet kur aplikanti ka tërhequr në mënyrë eksplicite aplikimin e tij ose të saj dhe rastet kur autoriteti përcaktues ka refuzuar një kërkesë pas tërheqjes së nënkuptuar të tij në përputhje me Neni 2, q) dhe nenin 28 (1) të DIREKTIVËS 2013/32/BE TË PARLAMENTIT DHE TË KËSHILLIT EVROPIAN e datës 26 qershor 2013 mbi procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare.

<sup>40</sup> <https://www.gov.uk/government/statistical-data-sets/asylum-and-resettlement-datasets>,

kosovarë 50% u refuzuan, 23 % morën një përgjigje pozitive, ndërsa tërheqje tjera të kërkesave ishin 27%.

Figura 26: Vendimet fillestare për azilkërkuessit kosovarë në Mbretërinë e Bashkuar (%)



Burimi: Home Office Immigration System Statistics

Ndarja sipas statusit të vendimit fillestar të azilkërkuessve kosovarë (në persona): statusi i refugjatit<sup>41</sup> 5, grante të tjera 2, refuzim i vërtetuar<sup>42</sup> 9, refuzime tjera<sup>43</sup> 6 dhe tërheqje të tjera<sup>44</sup> 8.

<sup>41</sup> Statusi i refugjatit (i njohur më parë si 'azil') u jepet aplikantëve për azil, sipas paragrafit 334, Pjesa 11 e Rregullorës të Imigrimit, për të njohur se ata kanë një frikë të bazuar nga persekutimi në vendin e tyre të origjinës ose në vendin e ish-rezidencës së zakonshme, për arsye të racës, fesë, kombësisë, opinionit politik ose anëtarësimit në një grup të caktuar shoqëror.

<sup>42</sup> Një kërkesë për azil vërtetohet kur kërkesa është "qartësisht e pabazuar". Kjo do të thotë se azilkërkuessi nuk mund, në asnjë mënyrë legjitime, të kualifikohet për statusin e refugjatit, Mbrojtje Humanitare, Pushim Diskrecionar ose leje për të qëndruar sipas rregullave familjare ose të jetës private.

<sup>43</sup> Refuzimet për pretendimet kur azilkërkuessi nuk i plotëson kushtet për statusin e refugjatit, mbrojtje humanitare, leje diskrecionale ose leje për të qëndruar sipas rregullave familjare ose të jetës private..

<sup>44</sup> Një kërkesë për azil mund të tërhiqet në mënyrë eksplicite (d.m.th. nëse aplikanti nënshkruan një formular për tërheqjen e një aplikimi), ose të tërhiqet nëse aplikanti largohet nga MB përpara një vendimi.

## 9. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

### 9.1. Përfundimet

Gjatë vitit 2022 statistikat e publikuara nga ASK konfirmojnë një numër të madh të qytetarëve tanë që kanë emigruar , kryesisht në shtetet e BE-së, ku krahasuar me vitin 2021 kemi rënie prej 3%. Ky trend i emigrimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës në mënyrë të rregullt rezulton edhe me rënien e theksuar të emigrimit të parregullt, ku kjo i atribuohet kërkesës për fuqi punëtore në veçanti në mesin e migrantëve.

Imigrimi i parregullt të huajve në Republikën e Kosovës shënoi një trend në rënie edhe gjatë vitit 2022. Edhe përkundër këtij trendi në rënie, institucionet e Republikës së Kosovës kanë vazhduar me zgjerimin e kapaciteteve pritëse dhe akomoduese për imigrantët e parregullt, si dhe është funksionalizuar Qendra e Përkohshme e Pritjes për Migrantë.

Ndërsa, gjatë këtij viti vërejmë një trend rritjeje tek imigrimi i rregullt dhe kjo vjen si shkak i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Lehtësimin e Procedurave dhe Kushteve për Marrjen e Lejeqëndrimit të Përkohshëm, për vitin 2022 për qytetarët e Shqipërisë.

Kontributi i diasporës në zhvillimin socio-ekonomik të vendit mbetet i pazëvendësueshëm, dhe viti 2022 shënon një ngritje rekorde të remitencave, kategorisë së turizmit të diasporës, si dhe IHD-ve që shumica vlerësohet se investohen nga pjesëtarët tanë të diasporës. Ky trend në rritje i kontributit të diasporës reflekton edhe nevojën e zhvillimit të politikave që kanë për qëllim fuqizimin e urave lidhëse në mes të institucioneve të Republikës së Kosovës, komunitetit në përgjithësi dhe mekanizmave të ndryshëm që përfaqësojnë diasporën dhe interesat e tyre.

## 9.2. Rekomandimet

1. Të avancohen sistemet që përmbajnë të dhëna dhe statistika të migrimit dhe shkëmbimi i tyre të përditësohet me qëllim të analizimit në parandalimin e keqpërdorimit të procesit të liberalizimit të vizave.
2. Ngritja e kapaciteteve për zyrtarët përgjegjës në temat që kanë të bëjnë me migrim, demografi dhe zhvillimin e analizave.
3. Të krijohet një modul në BMS që mundëson regjistrimin e diasporës gjatë vizitave në Kosovë (për qëllime statistikore).
4. Rekomandohet që Qeveria të hartoj politika që kanë për qëllim për promovimin e investimeve nga diaspora (Ligji për Investime Strategjike, Strategjia e Re e Diasporës, etj).- zhvendosje e konsumit të remitancave në interes të investimeve në biznese të reja.
5. Rekomandohet që të shqyrtohen mundësitë e themelimit të Fondit të Papunësisë.
6. Rekomandohet që të gjenerohen statistikat lidhur me bizneset me pronarë të huaj të regjistruar (sipas sektorëve).
7. Rekomandohet të bëhet një vlerësim i nevojave të tregut vendor të punës me qëllim të kuotës vjetore .